REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2018:063685
Datë: 26 .04.2021
Numri i dokumentit: 01748764

P.nr. 131/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Sabaheta Kurteshi, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Senida Nuri - punëtore e kësaj gjykate , në lëndën penale kundër të pandehurit H. Q. nga Dragash, me numër personal..., për shkak te veprës penale, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, nga neni 333 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prizren - Departamenti i përgjithshëm nr. PP/II.nr.2558-9/18 , të datës 16.10.2018 në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 11.03.2021, në praninë e Prokurorit të Shtetit Fatos Ajvazi, të pandehurit H. Q., mbrojtesit të tij av. A. R. të dëmtuarit A. D., më datë 11.03.2021 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 26.04.2021 përpiloi, këtë:

A K T GJ Y K I M

Kundër të akuzuarit :

H. Q., i lindur më..., me numër..., i biri i H. Q. dhe nënës S. Q., e gjinisë M., i martuar babë i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, me vendbanim në Dragash, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës.

Konform nenit 363 par 1 pika 1.3 të KPP-ës

REFUZOHET AKUZA

Se me datë, 19.05.2018, rreth orës 11:30 min , në fshatin B., Komuna e Dragashit , te vendi i quajtur " S. M.", me dashje ia asgjëson dhe ia bënë të pa përdorshme pasurinë e të dëmtuarit A., në atë mënyrë që i pandehuri i shtyrë nga ndjenja e xhelozisë dhe eliminimit të konkurrencës në mbledhjen e barishteve për qëllime të mjekësisë në Bjeshkët e fshatit B. dhe përmes përdorimit të një mjeti të pa identifikuar por të përshtatshëm për dëmtimin e sendit ,që dyshohet të jetë thikë ose kaçavidë, afrohet afër veturës së të dëmtuarit A. D. nga K., të parkuar në vendun si më lartë , ku nxjerr mjetin dhe me të dy gomat e veturës "BMW-318TDS", me

2018:063686

targa..., të anës së majtë të automjetit ia dëmton duke i shpuar , me çka të dëmtuarit i shkakton dëm material.

Me çka me këto veprime do të kishte kryer vepër penale , asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, nga neni 333 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovë

Për shkak se Prokurori i Shtetit heqë dorë nga akuza meqenëse nuk është vërtetuar – nuk është provuar se i pandehuri ka kryer veprën penale si më lartë .

I dëmtuari për realizimin e kërkesë pasurore - juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko –civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m

Prokurori i Shtetit –Prokuroria Themelore ne Prizren ka paraqitur ndaj të **H. Q., nga Dragashi, me nr. Personal..., i** akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.2558-9/18 të dt. 16.10.2018, për shkak të veprës penale, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, nga neni 333 par. 1 të Kodit Penal t**ë Republikës së** Kosovës,04/L-082,.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur 11.03.2021 , Prokurori i Shtetit Fatos Ajvazi ne fjalën përfundimtare Prokuror nga Prizreni nder tjera ka deklaruar : pas disa shqyrtimeve të më hershme dhe kësaj të sodit, ku përmes administrimit të provave , me asnjë mënyrë në asnjë provë nuk ka mundur të vërtetohet ekzistimi dhe kryerja e veprës penale si më lartë , andaj pasi që nuk është vërtetuar që i pandehuri ka kryer ketë vepër penale heqë dorë nga ndjekja e mëtejshme penale në mungesë të provave (shihë procesverbalin e datës 11.03.2021).

I dëmtuari gjatë shqyrtimeve gjyqësore ndër tjera ka deklaruar : se mbetët pranë deklaratës të dhënë në polici dhe kërkon kompensim dëmi .

I pandehuri gjate shqyrtimeve gjyqësore , ka deklaruar se nuk e ndien vetën fajtor dhe nuk e pranon fajësinë. .

Pasi qe paditësi Prokurori i shtetit i Prokurorisë Themelore ne Prizren është tërhequr nga akuza ndaj të pandehurit **për shkak të veprës penale** , asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, nga neni 333 par. 1 të Kodit Penal t**ë Republikës së** Kosovës,04/L-082, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I dëmtuari *për realizimin e kërkesë pasurore- juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko –civil në bazë të nenit 463,par.3 të KPP-ës.*

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 450. Par. 2. Lidhur me pikën 2.6 të KPP-së.

2018:063686

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2018:063685, 26.04.2021

G j y q t a r i

_____

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

2018:063686